UDHËZIMI 1
MBI TRANSFERTAT PËR VEPRIMET TREGTARE NË VALUTË

1. Transfertat për veprimet tregtare për mallrat

Transfertat për veprimet tregtare për mallrat, nga brenda-jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nga i njëjti subjekt gjatë një ditepune nga personat fizikë, juridikë, të kryhen kundrejt paraqitjes së dokumenteve të mëposhtme:

1.1. Kur pagesa kryhet paradhënie ose para mbërritjes së mallit në Republikën e Shqipërisë:

a) kërkesa për kryerjen e veprimit, ku jepet përshkrimi i natyrës dhe i qëllimit për të cilin kryhet, nënshkruar nga vetë kërkuesi. Po në këtë kërkesë, subjekti të deklarojë se dokumentacioni i paraqitur nuk është përdorur më parë për të justifikuar kryerjen e transfertave të tjera;

b) fatura pro-forma dhe kontrata ku përcaktohet dhe forma e pagesës;

c) akti i zhdoganimit të mallit :

c.1. Në rastet e pagesës së pjesshme të shumës totale, në përputhje me kushtet e kontratës, afati maksimal i paraqitjes së aktit të zhdoganimit të mallit të paguar është deri në tre muaj pas kryerjes së pagesës. Me kalimin e këtij afati nuk do të kryhet pagesa e rradhës për këtë mall deri në paraqitjen e aktit të zhdoganimit të mallit të paguar.

c.2. Në rastet e transfertave të pjesshme, kur operohet me magazinë doganore, sipas Kodit Doganor, pagesa e rradhës do të kryhet vetëm pas paraqitjes të aktit të zhdoganimit të mallit, për atë pjesë të zhdoganuar të tij, që ka qenë nën regjimin e magazinimit doganor.

Afati maksimal i paraqitjes së këtij dokumenti është 12 muaj nga data e importimit. Pranohet një shtyrje, për 12 muaj të tjerë, në rast se një gjë e tillë është pranuar nga organet që e kanë në kompetencë sipas Kodit Doganor. Pas këtij afati, pagesa e rradhës nuk do të kryhet deri në paraqitjen e aktit të zhdoganimit.

c.3. Në rastin e likuidimit të menjëhershëm të shumës së kontratës afati maksimal i paraqitjes së aktit të zhdoganimit të mallit të paguar është deri në tre muaj pas kryerjes së pagesës. Përjashtim bëjnë rastet kur afati i lëvrimit të mallit ose i kryerjes së shërbimit është përcaktuar ndryshe në kontratë, por jo më shumë se 12 muaj.

1.2.Kur pagesa kryhet pas mbërritjes së mallit në Republikën e Shqipërisë:

a) kërkesa si në pikën 1.1., gërma a;

b) akti i zhdoganimit të mallit.

1.3. Për transfertat në tregun e mallrave, që kalojnë transit në Republikën e Shqipërisë, zbatohen kërkesat e ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë".

1.4. Në rastin kur blerja dhe shitja e mallit realizohet nëpërmjet dy shteteve të ndryshme nga Shqipëria dhe malli nuk hyn në Shqipëri, por vetëm pagesa e mallit realizohet nëpërmjet Shqipërisë, transferta kryhet duke u bazuar në dokumentacionin e përcaktuar në pikën 1.1 të këtij udhëzimi. Kërkesa e pikës 1.1 gërma c, plotësohet me aktin e zhdoganimit të mallit të njërit prej këtyre shteteve.

2. Transfertat për veprimet tregtare për shërbimet

2.1. Për veprimet e transfertave tregtare, në çdo rast shërbimi, sipas specifikimeve të bëra në nenin 5.2 të rregullores “Për veprimtarinë valutore”, subjektet e licencuara kërkojnë nga klientët e tyre paraqitjen e dokumentacionit të mëposhtëm, sipas specifikave të secilit klient:

a) kërkesa sipas pikës 1.1., gërma a;

b) fatura përkatëse e subjektit ose një dokument, i cili vërteton qëllimin për të cilin kërkohet kryerja e transfertës;

c) kontrata ose marrëveshja përkatëse.